

ta hapnin kapinë e oborrit. Kur Xhemajli u afrua dhe e hapi kapinë, policët e vranë në vend. Më pas, shtënën mbi burrat në oborr. Në vend u vranë Haxhiu, Faiku, Qemajli, Eqremi, Nesimi, Xhemajli dhe Bakiu. Policët u larguan nga oborri për një kohë të shkurtër. Pas pak, u kthyen, i mbuluan trupat e pajetë të burrave me kashtën dhe ua dhanë flakën. Familjarët e tjerë pritën që të binte terri dhe, pastaj, u arratisën për në Celinë/Celina. Më vonë, kanë mësuar se policët serbë i kishin marrë me vete trupat e djegur të burrave të vranë dhe i kanë çuar në drejtim të panjohur. Në oborrin e Selamiut kanë mbetur vetëm mbetjet mortore të Xhemajlit. Ato, më 8.08.1998, i ka gjetur djali i tij Samiri. Gjendeshin prapa hambarit. Në të njëjtën ditë, Samiri i ka varrosur mbetjet mortore të të atit në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac. Mbetjet mortore të Nesimit u identifikuan më 16.07.2005. Familjarët e organizuan menjëherë varrimin e tyre. Ato ishin gjetur në varrezën masive në Serbicë të Poshtme/Donja Srbica [Prizren]. Mbetjet mortore të Qemajlit u identifikuan më 8.01.2004, ndërkaq ato të Haxhiut më 14.10.2007. Mbetjet mortore të Eqremit u zbuluan në varrezat përkaj grupës së bërllokut në Rahovec/Orahovac. Që të gjithë u varrosën në varrezat myslimane në këtë qytet.

Familjarët janë ende duke kërkuar për mbetjet mortore të Faikut dhe Bakiut. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rastet e tyre janë të regjistruar në lëndët me numrat BLG-804303-01 dhe BLG-804228-01.

Burimet: deklarata N. N, FDH-851; deklarata N.N, FDH-852; deklarata Xh.S, FDH-854; deklarata N.N, FDH-856; deklarata X.B FDH-863; deklarata N.N, FDH-866; deklarata N.N, FDH-874; deklarata N.N, FDH-877; deklarata G. S, FDH-881; deklarata A.S, FDH-2100; deklarata G. S, FDH-12935; deklarata F.S, FDH-32453; Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren, Kt. num. 83/99 (A. Kolašinac dhe të tjerë), aktakuza, 07.08.2000, FDH-8705; LBI, *Preliminar...*, 3, FDH-3631; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-26205; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Nexhmedin (Avdullah) Mushla

(20.05.1937, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, drejtor i Kryqit të Kuq në Rahovec/Orahovac, gjashtë fëmijë)

Nga mesnata, më 20.07.1998, policia serbe ka nisur të depërtonte në mëhallët përreth stacionit të autobusëve me arsyetimin se në shtëpitë shqiptare po fshiheshin pjesëtarë të UÇK-së. Nga frika prej policisë serbe, njerëzit filluan të largoheshin me vrap nga shtëpitë e veta. Afro 15 persona u grumbulluan në oborrin e Nexhmedin Mushles. Kur policët serb hapën zjarr, ata të gjithë kaluan në oborrin fqinj [**Rahovec/Orahovac**]. Policia ka hapur zjarr sërish ndaj tyre dhe një plumb e ka qëlluar për vdekje Nexhmedinin në kokë. Ka mbetur i shtrirë në tokë, ndërkaq të tjerë, përfshirë edhe familjarët e tij, ikën nga vendi i ngjarjes. Të nesërmen, familjarët e Nexhmedinit u kthyen dhe në oborr e gjetën trupin e tij. Nuk u lejuan nga policia serbe që ta varrosnin në varrezat e qytetit dhe e varrosën në oborrin e shtëpisë familjare. Në datën 21.08.1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Nexhmedinit në varrezat e qytetit.

Burimet: deklarata S.M, FDH-40656; J. Osmani, *Krimet...*, II, 246.

Nahit (Beza) Shehu

(20.08.1941, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, pesë fëmijë)

Bashkim (Kasim) Hajda

(26.08.1963, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, dy fëmijë)

Në mesin e qytetarëve, që në mëngjesin e datës 20.07.1998, u strehuan në Teqenë e shehMuhedinit [**Rahovec/Orahovac**], ishin edhe Bashkim Hajda me bashkëshorten Behijen, djalin, vajzën dhe të ëmën, si dhe Nahit Shehu me bashkëshorten Naxhijen. Rreth orës 12:00, ata në bazë të urdhrat të policisë serbe u detyruan të largoheshin nga Teqeja. Nahiti dhe Bashkimi dolën në rrugë dhe iu bashkëngjitën kolonës, e cila u nis drejt *Kadiri Xhamisë/Kadiri džamija*. Rrugëtimin e kolonës e kanë ndërprerë papritmasdyautoblinda të policisë serbe, nga të cilat shtëninë në ajër. Të kapluar me panik, qytetarët ia dhanë vrapit duke u shpërndarë